



GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. B., për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356, paragrafi 5., lidhur me paragrafin 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Pkr.nr.61/2021 të datës 24.05.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.596/2023 të datës 08.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 31.07.2023, mori këtë:

## A K T V E N D I M

Hedhet si jolëndore kërkesa e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurit I. B., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Pkr.nr.61/2021 të datës 24.05.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.596/2023 të datës 08.06.2023.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin Pkr.nr.61/2021 të datës 24.05.2023, të pandehurit I. B., i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356, paragrafi 5., lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri më datë 27.07.2023. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2., pikat 1.2.1. dhe 1.2.3. të KPP-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.596/2023 të datës 08.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përbashkët e mbrojtësve të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurit I. B., avokat Valdrin Gashi dhe avokate Emira Gavazaj Gashi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, sipas nenit 432, paragrafi 1., pika 1.3. të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovoi si të bazuar, aktvendimet e kundërshtuara t'i ndryshoi dhe të pandehurit t'ia ndërpres menjëherë masën e paraburgimit.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.158/2023 e datës 28.07.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të hedhet si jo lëndore.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është jo lëndore.

Siç del nga shkresat e lëndës, të pandehurit gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin Pkr.nr.61/2021 të datës 24.05.2023, ia ka vazhduar paraburgimin për 2 (dy) muaj, i cili do të mund t'i zgjaste deri më datë 27.07.2023. Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr.596/2023 të datës 08.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përbashkët të mbrojtësve të pandehurit. Ndaj këtyre aktvendimeve mbrojtësit të të pandehurit kanë paraqitur kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila kërkesë është pranuar në këtë gjykatë më datën 27.07.2023, është dërguar tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për përgjigje, nga është kthyer me datën 28.07.2023 dhe iu është dorëzuar kolegjit në punë, pra kërkesa është pranuar nga kolegji pasi që të pandehurit i ka skaduar vazhdimi i paraburgimit (deri më 27.07.2023).

Duke pas parasysh faktin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pranuar tek kolegji pasi që të pandehurit i ka skaduar afati i vazhdimi të paraburgimit, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa nuk mund të jetë objekt shqyrtimi dhe si e tillë është jolëndore sepse pavarësisht shkeljeve të pretenduar në kërkesë i pandehuri e ka mbajtur paraburgimin në kohëzgjatje që i është vazhduar.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 435, paragrafi 2. të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.379/2023, më datë 31.07.2023

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka